Siguri

Bëni të mundur që tensioni i furnizimit me energji në rrjetin tuaj të brendshëm të përputhet me tensionin e treguar në pullën identifikuese të vendosur në pjesën e prapme të pajisjes tuaj. Në rastin kur spina e furnizimit me energji, priza AC apo një bashkues pajisje përdoret si aparat shkëputje, do të mbetet e gatshme për përdorim.

Në disa modele të caktuara, treguesi i dritës vendoset në pjesën anësore të pajisjes televizive (TV). Mungesa e një treguesi të dritës në pjesën e përparme nuk do të thotë se Televizori është plotësisht i shkëputur nga rrjeti elektrik. Për të shkëputur tërësisht pajisjen televizive (TV), duhet të hiqet priza e rrjetit.

Përbërësit e pajisjes televizive (TV) janë të ndjeshëm karshi të nxehtit. Temperatura **maksimale e mjedisit rrethues** nuk duhet të kalojë **35º** Celsius. Mos i mbuloni hapjet në pjesën e pasme apo anësore të pajisjes televizive (TV). Lini hapësirë të mjaftueshme rreth pajisjes në mënyrë që të lejoni ajrosjen e duhur. Instaloni pajisjen larg nga çdo burim ngrohje (oxhak, etj) ose pajisje tjetër që krijon fushë të fuqishme magnetike apo elektrike.

Lagështia në dhomat ku është instaluar pajisja televizive nuk duhet të jetë më shumë se **75%** lagështi. Zhvendosja e pajisjes televizive nga një vend i ftohtë në të ngrohtë mund të shkaktojë kondensim në ekran (dhe tek disa komponentë të vendosur brenda pajisjes televizive (TV). Lejoniqë të largohet kondensimi përpara se të ndizni përsëri Televizorin.

Butoni ⏻ or **POWER**/⏻ në pajisjen televizive ose ⏻ butoni në telekomandë mund të përdoret për ta ndezur atë dhe për ta vënë atë në gjendje pritje. Nëse ju **nuk do të shihni TV për një periudhë të gjatë kohore**, shuajeni atë tërësisht duke hequr spinën nga priza e furnizimit me energji.

Gjatë **stuhive**, ne ju rekomandojmë që të shkëputni pajisjen televizive (TV) nga rrjeti elektrik dhe ajror në mënyrë që të mos preket nga rritja e papritur e tensionit elektrik ose elektromagnetik që mund ta dëmtojë atë. Për këtë arsye, mbani **prizat e rrjetit elektrik dhe ato ajrore** të arritshme në mënyrë që ato të mund të **shkëputen**, nëse do të ishtë e nevojshme.

Shkëputni menjëherë Televizorin nga priza nëse vëreni se po jep një **erë djegie** apo **tym**. Nuk duhet që asnjëherë, në asnjë rrethanë, ta hapni vetë TV, duke qenë se mund të përballeni me rrezikun e një **goditje elektrike** nëse veproni në këtë mënyrë.

PARALAJMËRIME

Kjo pajisje synon të përdoret vetëm për përdorim shtëpiak dhe nuk duhet të përdoret për ndonjë aplikim tjetër, si për shembull për përdorim jo-shtëpiak apo në një mjedis tregtar.

Nëse kablloja e jashtme fleksibël ose kordoni i këtij produkti është dëmtuar, duhet të zëvendësohet nga prodhuesi ose agjenti i tij i shërbimit ose nga një person i kualifikuar i këtij niveli për të shmangur një rrezik të mundshëm.

Lejoni më tepër se 10 cm boshllëk rreth e përqark televizorit për të mundësuar ajrimin e duhur. Ajrosja nuk duhet të pengohet nga mbulimi i hapjeve për ajrim me elementë, të tillë si gazeta/revista, mbulesa tavoline, perde, etj.

Pajisja nuk duhet të ekspozohet ndaj pikimeve dhe spërkatjeve me ujë dhe asnjë objekt i mbushur me lëng, si p.sh vazo, nuk duhet të vendoset mbi të.

Bateritë (pako e baterive apo bateri të instaluara) nuk duhet të ekspozohen ndaj nxehtësisë së tepruar siç janë drita e diellit, zjarri ose të ngjashme me këto.

Për të reduktuar rrezikun e zjarrit apo të goditjeve elektrike, mos e ekspozoni pajisjen ndaj shiut ose lagështirës.

Një aparat televiziv mund të bjerë, duke shkaktuar dëmtime serioze personale ose vdekje. Shumë dëmtime, veçanërisht tek fëmijët, mund të shmangen duke marrë masa paraprake të thjeshta si:

- GJITHMONË përdorni kabinete ose stenda ose metoda montimi të rekomanduara nga prodhuesi i aparatit televiziv.
- GJITHMONË përdorni mobilje që mund të mbështesin në mënyrë të sigurt televizorin.
- GJITHMONË sigurohuni që aparati televiziv nuk varet nga skaji e mobiljeve mbështetëse.
- GJITHMONË edukoni fëmijët për rreziqet e ngjitjes në mobilje për të arritur televizorin ose komandat e tij.
- GJITHMONË drejtoni zingjirët dhe kabllot e lidhura me televizorin tuaj në mënyrë që ato të mos mund të shkelen, tërhiqen ose kapen.
- ASNJËHERË mos e vendosni një televizor në një vend të paqëndrueshëm.
- ASNJËHERË mos e vendosni televizorin në mobilje të larta (për shembull, dollapë ose rafte librash) pa ankoruar mobiljet dhe televizorin në një mbështetëse të përshtatshme.
- ASNJËHERË mos e vendosni televizorin në pëlhurë ose materiale të tjera që mund të vendosen midis televizorit dhe mobiljeve mbështetëse.
- ASNJËHERË mos vendosni sende që mund t'i tundojnë fëmijët të ngjiten, të tilla si lodrat dhe telekomandat, në majë të televizorit ose mobiljeve në të cilat vendoset televizori.

Nëse televizori ekzistues po mbahet dhe zhvendoset, duhet të zbatohen të njëjtat konsiderata si më sipër.



Pajisje me këtë simbol është një aparat i Klasës II ose pajisje elektrike me izolim të dyfishtë. Është konceptuar në mënyrë të tillë që të mos ketë nevojë për një lidhje të sigurisë në tokë elektrike. Pajisje pa këtë simbol është një aparat elektrik i Klasës I. Pajisja do të të lidhet me një prizë të furnizimit me energji me anë të një lidhje tokëzimi mbrojtëse.



Për të parandaluar përhapjen e zjarrit, mbani qirinjtë apo burimet e tjera të lira të flakëve larg nga ky produkt në çdo kohë.



Ky simbol tregon praninë e voltazhit të lartë në brendësi. Kontakti me ndonjë nga pjesët e brendshme të këtij produkti përbën rrezik.



Simboli tregon se siguresa mund të jetë në përcjellësin neutral dhe se rryma kryesore do të shkëputet për të stakuar energjinë nga përcjellësit e fazës.

Për të parandaluar dëmtimin, ky aparat duhet të jetë i bashkangjitur në mënyrë të sigurt në dysheme/mur në përputhje me udhëzimet e instalimit.

Për të zvogëluar rrezikun e ekspozimit të RF, distanca e përdorimit të këtij aparati duhet të jetë së paku 100 cm.

Nëse me produktin është e lidhur një antenë e jashtme ose sistem kabllor, sigurohu që antena ose sistemi kabllor të tokëzohet nga një person i kualifikuar, për të siguruar mbrojtje ndaj tensionit dhe ngarkesave statike të akumuluara.

Ekrani i Televizorit

Ekrani i TV i përdorur në këtë produkt është bërë prej qelqi. Për këtë arsye, ai mund të thyhet kur produkti bie apo kur përplaset me objekte të tjera.

Ekrani i TV është një produkt i teknologjisë shumë së lartë, i cili ju jep pamje me detaje tejet të hollësishme. Në raste të caktuara, disa piksela joaktivë mund të bëhen të dukshëm në ekran si një pikë e caktuar me ngjyrë të kaltër, të gjelbër apo të kuqe. Kjo nuk ndikon në performancën e produktit tuaj.

Kujdesi

Përdorni një produkt për pastrimin e qelqit për të pastruar ekranin dhe një leckë të butë dhe pastrues të butë për të pastruar pjesën tjetër të pajisjes së televizorit.

E rëndësishme: Përdorimi i detergjentëve të fuqishëm, me bazë alkooli dhe produktet gërryese mund të dëmtojnë ekranin.

Pastroni pluhurin në hapjet e vendosura në anën e pasme dhe pjesën anësore në mënyrë të rregullt. Përdorimi i tretësve, produkteve gërryese ose me bazë alkooli mund të dëmtojnë televizorin. Nëse një objekt apo lëng hyn tek pajisja, stakojeni atë menjëherë dhe dërgojeni për ta kontrolluar tek një inxhinier i autorizuar. Asnjëherë mos hapni vetë pajisjen pasi kjo mund t'ju vërë në rrezik ose të dëmtojë pajisjen.

Rregullorja ESD

Kjo pajisje i plotëson kriteret e performancës ESD. Në rast se aparati nuk rikuperohet në regjimin e lidhjes me Ethernet ose me lexim USB për shkak të shkarkimit elektrostatik, nevojitet ndërhyrja e përdoruesit.

Njoftim i funksionit Bluetooth

Teknologjia Bluetooth® (nëse është e disponueshme në TV tuaj) përdor frekuenca 2.4GHz të cilat mund të shkaktojnë ndërhyrje të transmetimit audio nëpërmejt Bluetooth në afërsi të pikave hyrëse të Wi-Fi, Ruterave dhe furrave me mikrovalë. Nëse ju përballeni me ndërprerje të marrjes së zërit ju duhet të rindizni pajisjen tuaj Bluetooth për të gjetur një frekuencë me më pak ndërhyrje dhe nëse vazhdoni të keni probleme ju duhet të afroheni më pranë TV tuaj ose të zmadhoni largësinë midis TV dhe burimit të ndërhyrjes.

ID-ja e Deklarimit të Bluetooth: D043135

Montimi i Televizorit në mur

Paralajmërim: Ky operacion kërkon të paktën dy persona, në varësi të madhësisë së televizorit tuaj.

Për të siguruar një instalim të sigurt, respektoni shënimet e mëposhtme të sigurisë:

- Kontrolloni nëse muri mund të mbajë peshën e pajisjes së televizorit dhe tërësinë e elementëve që duhen për montimin në mur.
- Ndiqni udhëzimet e montimit të cilat mundësohen me montimin në mur. Për modele të caktuara, sigurohuni që të vidhosni vidat gjashtëkëndore VESA të montimit në mur (dhe vidat) të cilat vihen në dispozicion me grupin e dadove për montimin në mur në pjesën e pasme të pajisjes tuaj përpara montimit tuaj në mur.
- Pajisja e Televzorit (TV) duhet të instalohet në një mur vertikal.
- Sigurohuni që të përdorni vetëm vida të përshtatshme për materialin e murit.
- Sigurohuni që kabllot e TV të pajisjes janë vendosur në mënyrë që të mos ketë rrezik pengimi dhe rrëzimi prej tyre.

Të gjitha masat e tjera të sigurisë për pajisjet tona televizive janë gjithashtu të zbatueshme këtu.

Manuali shumë përdorimësh i përdoruesit

Karakteristikat e përshkruara në këtë manual janë të zakonshme për shumicën e modeleve. Disa karakteristika mund të mos jenë të disponueshme në TV tuaj dhe / ose TV juaj mund të përfshijë karakteristika që nuk janë përshkruar në këtë manual të përdoruesit. Ilustrimet në këtë manual mund të ndryshojnë nga produkti aktual. Ju lutem referojuni produktit aktual.

Azhurnimi i pajisjes

Zakonisht, disa pajisje azhurnohen çdo tre muaj, por jo gjithmonë aq specifikisht. Disa pajisje, veçanërisht ato që dolën në shitje më shumë se tre vjet më parë, do të azhurnohen vetëm nëse gjendet dhe rregullohet një dobësi kritike.

Informacion për Përdoruesit lidhur me Hedhjen e Pajisjeveve dhe Baterive të Vjetra

[Bashkimi Europian]



Produktet

Këto simbole tregojnë se pajisjet elektrike dhe elektronike si dhe bateria me këtë simbol nuk duhet të hidhen tek mbeturinat e përgjithshme shtëpiake në fund të ciklit të jetës së tyre. Në vend të kësaj, produktet duhet të dorëzohen në pikat përkatëse të grumbullimit për riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike, si dhe të baterive për trajtimin e duhur, rigjenerimin dhe riciklimin, në përputhje me legjislacionin tuaj kombëtar dhe Direktivën 2012/19/BE, 2006/66/EC, 2008/12/EC.



Pb

Bateri

Vini re:

Shenja Pb poshtë simbolit për baterit tregon se bateria përmban plumb.

Duke asgjësuar këto produkte në mënyrën e duhur, ju do të ndihmoni në ruajtjen e burimeve natyrore dhe do të ndihmoni për parandalimin e efekteve të mundshme negative në mjedis dhe në shëndetin e njeriut të cilat në të kundërt do të shkaktoheshin nga trajtimi i papërshtatshëm i mbetjeve të këtyre produkteve.

Për më shumë informacion në lidhje me pikat e grumbullimit dhe riciklimit të këtyre produkteve, ju lutem kontaktoni zyrën tuaj lokale të bashkisë, shërbimin në dispozicion të mbeturinave shtëpiake ose dyqanin ku keni blerë produktin.

Mund të jenë të zbatueshme ndëshkime për përdorimin jo të saktë të këtyre mbetjeve, në përputhje me legjislacionin kombëtar.

[Përdoruesit e biznesit]

Në qoftë se ju dëshironi ta shkatërroni këtë produkt, ju lutem kontaktoni furnizuesin tuaj dhe kontrolloni termat dhe kushtet e kontratës së blerjes.

[Vendet e tjera jashtë Bashkimit Europian]

Këto simbole janë të vlefshme vetëm në Bashkimin Europian. Në qoftë se ju dëshironi t'i shkatërroni këto pajisje, ju lutem veproni, në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi si dhe me rregulloret e tjera në vendin tuaj për trajtimin e baterive dhe pajisjeve të vjetra elektrike.

Deklarata e konformitetit

CE

TCL deklaron në këtë mënyrë se TV i llojit të pajisjes radio është në përputhje me Direktivën 2014/53/EU. Teksti i plotë i Deklaratës së Konformitetit të BE-së gjendet në adresën e mëposhtme të internetit: www.tcl.com. Zgjidhni emrin e modelit dhe shkoni te SHKARKIM.

Figurat dhe ilustrimet në këtë Manual Përdorimi jepen vetëm për referencë dhe mund të ndryshojnë nga pamja e produktit aktual. Dizajni i produktit dhe specifikimet mund të ndryshohen pa njoftim.

Përmbajtja

Shqiptar

Informacion i rëndësishëm 1

Kapitulli 1 - Lidhjet

Lidh furnizmin me energji dhe antenën..... 5
Lidh Aparatin e Diskut Blu-ray, lojën konsol HD, videokameran HD, kufjet, modulin CI 5
Lidhuni në internet 6

Kapitulli 2 - Guida udhëzuese

Telekomandë e veçantë 7
Instalimi i baterive 8
Ndiz dhe shuaj TV 9
Konfigurimi fillestar 9

Kapitulli 3 - Veprimet bazë të TV

Përdorimi i kanaleve 10
Vëzhgimi i pajisjeve të lidhura 10
Përshtatja e volumit 10
Duke hyrë në faqen kryesore të Smart TV 10
Përdorimi i menusë së Cilësimeve 10

Kapitulli 4 - Përdorimi i funksioneve shtesë të TV tuaj

Instalimi i kanaleve 11
Ndërfaqe e përbashkët 11
Përdorimi i modulit të ndërfaqes së përbashkët 11
Përdorimi i shërbimeve të përbashkëta të ndërfaqes 11
Përdorimi i titrave 11
Aktivizimi/ç'aktivizimi i titrave 11
Aktivizimi i gjuhëve të titrave në kanalet televizive dixhitale 12
Përzgjedhja e një tipi titrash në kanalet televizive dixhitale 12
Përdorimi i Teletekstit 12
Përzgjedhje e deshifrimit të faqes së gjuhës ... 12
Gjuha Dixhitale e Teletekstit 12
Kontrolli Elektronik i Konsumatorit (CEC)..... 12
Aktivizimi apo ç'aktivizimi i CEC 12
Përdorimi i Ndezjes Automatike 12
Përdorimi i Pauzës Automatike 12
HbbTV 12
Hyrja në HbbTV 13
Ç'aktivizimi i HbbTV 13
Përdorim i EPG (Udhëzuesi i Programit Elektronik) 13
Funksioni Bluetooth 13
Funksioni i fillimit të shpejtë 14
Rrjeti po zgjohet 14
Rikthimi në cilësimet e paracaktuara fabrikisht ... 14
Përdorimi i kontrollit zanor pa duar të televizorit ... 14
Shpejtësia e Ndryshueshme e Rifreskimit 15
Apple AirPlay dhe HomeKit..... 15
Multi Vizuale 15
Filtri i Dritës Blu..... 16

Kapitulli 5 - Informacione të tjera

Fjalëkalimi në Kontrollin Prindëror..... 17
Zgjidhja e problemeve 17

Lidh furnizmin me energji dhe antenën

Për të ndezur TV pas lidhjes së kabllos të furnizmit me energji, shtyp ⏻ apo **POWER**/⏻.

Shënime:

- Pozicioni i prizës ndryshon në përputhje me modelin e TV.

- Shkëputni kabllon e furnizimit me energji para lidhjes së pajisjeve.



Lidh Aparatin e Diskut Blu-ray, lojën konsol HD, videokameran HD, kufjet, modulin CI



*Shënim: Sigurohuni që **OPTICAL** (OPTIKE) të jetë aktivizuar në menynë **Display and sound** (Ekrani dhe zëri) përpara se të përdorni funksionin **OPTICAL** (OPTIKE). Për ta aktivizuar, përdorni telekomandën për të shtypur ⚙, zgjidhni **Settings > Display and sound > Sound > Audio output > Optical** (Cilësimet > Ekrani dhe zëri > Tingulli > Dalja audio > Optikën) dhe më pas shtypni **OK**.*

Lidhuni në internet

Shënim: Udhëzimet e mëposhtme janë thjesht mënyrat e zakonshme për lidhjen e TV tuaj në rrjetin me lidhje kabllore apo valore. Mënyra e lidhjes mund të jetë e ndryshme në varësi të konfigurimit aktual të rrjetit tuaj. Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me rrjetin tuaj, ju lutem kërkoni ndihmë tek ofruesi juaj i shërbimit të internetit.

Lidhje kabllore



Lidhje valore



Cilësimet e rrjetit:

1. Shtypni ✿ në telekomandë për të shfaqur menunë e panelit.
2. Zgjidhni Settings (Cilësimet) dhe shtypni **OK** për të hyrë në menunë e cilësimeve.
3. Shtypni ∧ / ∨ për të zgjedhur **Network and Internet** (Rrjeti dhe internet), shtypni **OK** për të hyrë te nënmenyja dhe ndiqni udhëzimet në ekran për të konfiguruar rrjetin.

Shënime:

- *TV juaj mund të mos disponojë të gjitha lidhjet e dukshme në diagramin e mësipërm. Numri i portave USB dhe HDMI mund të ndryshojë në përputhje me modelin e TV.*
- *Pozicionet e butonave dhe lidhjeve mund të ndryshojnë në përputhje me modelin e TV.*
- *Lidhjet USB përdoren për futjen e të dhënave nga drajverat USB dhe për lidhjen e pajisjeve të tjera përkatëse USB aty ku është e aplikueshme.*
- *Të gjitha pajisjet USB duhet të lidhen direkt me pajisjen e Televizorit pa patur nevojë për zgjatues kabllorë. Në rastet kur kërkohet zgjatuesi kabllor, gjatësia maksimale e rekomanduar është 50 cm. Zgjatuesit e përmasave më të mëdha duhet të disponojnë bobinën me rruaza ferrite.*
- *Funksioni eARC/ARC (Kanali i Rikthimit Audio/ Audio Return Channel) mbështetet vetëm në portën HDMI të identifikuar me eARC/ARC. Për të përdorur funksionin eARC/ARC, ju lutem aktivizoni paraprakisht funksionin CEC siç është përshkruar në seksionin **CEC**.*
- *Rekomandohet përdorimi i kabllove HDMI të mbrojtura mirë dhe me cilësi të lartë për të shmangur ndërhyrje të mundshme.*
- *Ju lutem përdorni kufje me lidhje TRS prej 3.5mm. Presioni i tepruar zanor që vjen nga kufjet mund të shkaktojë humbje të dëgjimit.*

Kapitulli 2 - Guida udhëzuese

Telekomandë e veçantë

Shumica e funksioneve të televizionit tuaj janë të disponueshme përmes menuve që shfaqen në ekran. Telekomanda që vjen bashkë me pajisjen e televizorit mund të përdoret për të lundruar përmes menuve dhe për të përcaktuar të gjithë cilësimet e përgjithshme.



	Për t'a fikur dhe ndezur përsëri zërin.
	Gjendje gatishmërie / Dalje nga gjendja e gatishmërisë.
Numeric buttons	Për të futur numrat e kanaleve ose ndonjë shifër.
	Për të përzgjedhur burimin e hyrjes.
	Për të shfaqur panelin e Cilësimeve të Shpejta.
Colour buttons	Për të zgjedhur funksionet ose faqet e teletekstit; për t'u përdorur për funksionin HbbTV.
	Për të hyrë në Qendrën e Përdoruesit.
	Shtypni butonin e **Google Assistant** (Asistentit të Google) në telekomandë për të folur me Google Assistant (Asistentit të Google). *(E disponueshme vetëm në modalitetin Google TV dhe në rastet kur lidhja me rrjetin është normale.)*
	Për të shfaqur menunë e pultit.
∧ / ∨ / 〈 / 〉	Butonat e drejtimit të navigimit.
OK	Për të konfirmuar një hyrje ose përzgjedhje. (E disponueshme për shfaqjen e listës së kanaleve në modalitetin TV.)
	Për t'u rikthyer në menunë e mëparshme ose për të dalë nga një aplikacion.
	Për të hyrë në faqen kryesore të televizorit Smart TV.
	Për të hyrë në Udhëzuesin Elektronik të Programeve (i disponueshëm vetëm për kanalet dixhitale). Ose për akses në DTV EPG. (E disponueshme vetëm në modalitetin Google TV.)
VOL+ / —	Për të kontrolluar volumin.
LIST	Për të hyrë në listën e kanaleve DTV.
*	Për të hyrë në freeviewPlay.
	Për të shfaqur informacionin rreth programit, nëse është i disponueshëm.
CH∧ / ∨	Për të ndryshuar kanalet.
NETFLIX	Për të hyrë në Netflix nëse është i disponueshëm.
prime video	Për të hyrë në Prime video nëse është e disponueshme.
Youtube	Për të hyrë në Youtube nëse është i disponueshëm.
TCL CHANNEL	Për të hyrë në TCL Channel.
TCL HOME	Për të hyrë në TCL Home.
Web	Për të hyrë në TCL BrowseHere.

Shënime:

- *Kjo telekomandë është e disponueshme vetëm për modelet e përzgjedhura. Lloji i telekomandës mund të ndryshohet pa paralajmërim.*
- *Butonat e aplikacioneve mund të ndryshojnë në varësi të modelit. Butoni i aplikacioneve përdoret për të hyrë në aplikacionin përkatës.*
- *Ndiqni udhëzuesin në ekran për të çiftuar telekomandën me televizorin kur shtypni për herë të parë butonin e **Google Assistant** (Asistentit të Google).*
- *Google TV është emri me përvojë i softuerit të kësaj pajisjeje dhe një markë tregtare e Google LLC.*
- Google Assistant *(Asistentit të Google) nuk është i disponueshëm në gjuhë dhe vende të caktuara.*

Instalimi i baterive

1. Shtyni për hapjen e kapakut të pasmë siç tregohet në ilustrim.
2. Vendosni dy bateri AAA sipas polaritetit të shënuar në kutinë e baterive.
3. Vini në vend kapakun e pasmë siç tregohet në ilustrim.



Shënim: Tipi i telekomandës mund të ndryshohet pa njoftim paraprak.

KUJDES: Rrezik zjarri ose shpërthimi nëse ndërroni baterinë e llojit të gabuar.

E rëndësishme:

Bateritë nuk duhet të ekspozohen ndaj nxehtësisë së tepruar siç mund të jenë drita e diellit, zjarri ose të ngjashme. Hiqni baterinë në rastet kur telekomanda nuk do të përdoret për një kohë të gjatë. Bateritë e lëna brenda pajisjes mund të shkaktojnë dëme përmes përkeqësimit dhe rrjedhjes së lëngut gërryes (acid), duke e bërë të pavlefshme garancinë.

Për të mbrojtur mjedisin, përdorni impiantet lokale të riciklimit për asgjësimin e baterisë. Asgjësoni baterinë e përdorura në përputhje me udhëzimet.

KUJDES: Rrezik shpërthimi nëse bateritë janë zëvendësuar me një tip të gabuar. Zëvendësojini ato vetëm me të njëjtin lloj apo me një ekuivalent të tyre, që rekomandohet nga prodhuesi i pajisjeve.

Nëse bateritë në telekomandën tuaj po mbarojnë, ju mund të përdorni butonat e televizorit.

Mund ta ndizni televizorin nga regjimi i pritjes duke shtypur butonin ⏻ tek televizori.

Ndërkohë që televizori është i ndezur, menyja shumëfunksionale shfaqet kur shtypni butonin ⏻ tek televizori. Për më shumë informacion rreth përdorimit të menysë shumëfunksionale, referojuni figurës së mëposhtme.



- Shtypni butonin ⏻ për ta lëvizur theksimin në përzgjedhjen e funksionit tjetër.
- Shtypni dhe mbani shtypur butonin ⏻ për më shumë se 2 sekonda për të konfirmuar përzgjedhjen.

Shënim: Referojuni udhëzuesit të ndihmës së shpejtë për të gjetur butonin ⏻ tek televizori.

Ndiz dhe shuaj TV

1. Kur lidhet kablloja e furnizimit me energji, TV do të ndizet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose do të jetë në gjendje pritje (në pauzë). Nëse Televizori është në modalitetin e pritjes, shtypni ⏻ apo butonin **POWER**/⏻ në pajisje apo ⏻ butonin në telekomandë për ta ndezur atë.
2. Për të vënë televizorin në modalitetin e pritjes, shtypni butonin ⏻ në telekomandë. Pajisja e TV mbetet e ndezur, por me konsum të ulët të energjisë.
3. Për të shuar TV, hiqni spinën nga priza elektrike.

Shënim: Për të kursyer energji dhe mbrojtje të mjedisit, disa modele janë projektuar me çelësa stafetë. Kur televizori ndizet ose fiket, është normale të dëgjosh tingullin e stafetës.

Konfigurimi fillestar

Herën e parë që aktivizoni tërësinë e pajisjes shfaqet **Welcome** (Mirë se erdhët) në ekran, që iu drejton përmes procesit të instalimit fillestar. Ndiqni udhëzimet në ekran për të përfunduar procesin e konfigurimit fillestar si p.sh zgjedhjen e gjuhës, lidhjen me rrjetin, skanimin e kanaleve, si dhe shumë të tjera. Gjatë çdo hapi, bëni një zgjedhje ose kapërceni hapin. Nëse e kapërceni një hap, ju mund ta bëni më vonë konfigurimin nga menuja e cilësimeve.

Shënim: Nëse kërkimi i kanaleve zbuloi vetëm kanalet analoge kjo që mund të shkaktohet nga transmetimi i dobët dhe për këtë arsye nuk mbulohet nga garancia e prodhuesit. Prodhuesit nuk mund të konsiderohen përgjegjës për mungesën e transmetimeve apo për transmetim të dobët në disa zona.

Përdorimi i kanaleve

Përdorimi i butonave të Drejtimit të Navigacionit: shtypni ∧ / ∨ në telekomandë për të lëvizur për të ndryshuar kanalet.

Përdorimi i butonit OK: shtypni butonin **OK** për të shfaqur listën e kanaleve dhe shtypni ∧ / ∨ / 〈 / 〉 dhe **OK** për të zgjedhur kanalet.

Nëpërmjet përdorimit të butonave CH∧ / ∨: shtypni butonat **CH∧ / ∨** në telekomandë për t'u zhvendosur nëpër kanale.

Nëpërmjet përdorimit të butonit LIST (LISTA): shtypni butonin **LIST** (LISTA) në telekomandë për të shfaqur listën e kanaleve dhe shtypni ∧ / ∨ / 〈 / 〉 dhe **OK** për të përzgjedhur kanalet.

Vëzhgimi i pajisjeve të lidhura

Shtypni ⏎ në telekomandë për të shfaqur listën e burimeve. Shtypni 〈 / 〉 për të zgjedhur TV ose burime të tjera të dhënash dhe shtypni **OK** për të konfirmuar.

Përshtatja e volumit

Kontrolli i volumit: shtypni butonat **VOL+ / —** në telekomandë ose butonat përkates në televizor për të rritur apo ulur volumin.

Audio e ç'aktivizuar: shtypni 🔇 butonin për të ç'aktivizuar përkohësisht funksionin zanor. Shtypni këtë buton përsëri ose butonin **VOL+** për të rikthyer zërin.

Duke hyrë në faqen kryesore të Smart TV

Ju lejon që të shijoni Aplikacione Interneti (Apps) dhe faqe interneti të përshtatura në mënyrë të vecantë, dhe të rregulloni paramatrat e sistemit në televizorin tuaj. Ju mund të bëni kontrollin me telekomandën e Televizorit.

PARALAJMËRIM:

- Konfiguroni cilësimet e rrjetit para se të përdorni aplikacionet e TV Intelegjent (Smart TV).
- Mund të ketë ndërprerje dhe/ose përgjigje të ngadalshme, në varësi të kushteve të rrjetit tuaj.
- Nëse hasni ndonjë problem gjatë përdorimit të një aplikacioni, ju lutem kontaktoni ofruesin e përmbajtjes.
- Sipas rrethanave të ofruesit të përmbajtjes, përditësimi i aplikacionit apo vetë aplikacioni mund të ndërpritet.
- Në varësi të rregullave të vendit tuaj, disa aplikacione mund të kenë shërbim të kufizuar ose nuk mbështeten.
- Ndryshimet në përmbajtjen e aplikacioneve mund të bëhet pa njoftim paraprak nga ofruesi i shërbimit.

1. Shtypni ⌂ në telekomandë për të shfaqur faqen kryesore të Smart TV.
2. Shtypni ∧ / ∨ / 〈 / 〉 dhe **OK** për tu futur në App-et e dëshiruara, funksionet ose cilësimet.
3. Shtypni ← për tu kthyer në faqen kryesore.

Shënim: Duke qenë se lidhja me internet merr kohë, rekomandohet që ju të prisni disa minuta për të përdorur funksionin e TV Intelegjent (Smart TV) pas aktivizimit të TV nga gjendja e pritjes/në pauzë.

Përdorimi i menusë së Cilësimeve

Ju lejon të rregulloni cilësimet e televizorit, të tilla si figura dhe tingulli.

1. Shtypni ⚙ në telekomandë për të shfaqur menunë e panelit.
2. Zgjidhni Settings (Cilësimet) dhe shtypni **OK** për të hyrë në menunë e cilësimeve.
3. Në nën menutë, shtypni ∧ / ∨ për të zgjedhur opsionet e menusë, më pas shtypni **OK** / 〉 për të hyrë në listën e opsioneve, ose nënmenutë përkatëse, ose shtypni **OK** për të ndezur ose fikur, ose shtypni 〈 / 〉 për të rregulluar cilë simin.
4. Shtypni ← për t'u kthyer në menunë e mëparshme.

Instalimi i kanaleve

Ky seksion përshkruan mënyrën e kërkimit dhe ruajtjes së kanaleve në mënyrë automatike. Kjo mund të realizohet në secilin prej rasteve të mëposhtme:

- ju keni anashkaluar hapin e instalimit të kanaleve në konfigurimin fillestar;
- ju do të njoftoheni që nuk ka kanale në modalitetin TV;
- ju dëshironi të përditësoni kanalet tuaja.

1. Në modalitetin TV, shtypni ✿ në telekomandë dhe zgjidhni **Settings > Channels and inputs > Channel > Channel scan** (Cilësimet > Kanalet dhe hyrjet > Kanali > Skanimi i kanalit). Shtypni **OK /** 〉 për të hyrë.
2. Televizori instalon dhe i sistemon kanalet sipas vendit ose rajonit. Shtypni ∧ / ∨ për të zgjedhur **Country/Region** (Vendi/Rajoni) dhe shtypni **OK** / 〉 për të hyrë. Shkruani fjalëkalimin e parazgjedhur 1234 ose fjalëkalimin tuaj në rast se keni ndryshuar fjalëkalimin në menynë **Settings > System > Lock** (Cilësimet > Sistemi > Blloko). Shtypni ∧ / ∨ për të zgjedhur vendin ose rajonin dhe shtypni **OK** për ta konfirmuar.
3. Shtypni ∧ / ∨ për të zgjedhur **Automatic search** (Kërkim automatik), më pas shtypni **OK** për t'u futur.
4. Shtypni ∧ / ∨ për të përzgjedhur **Tuner mode** (Modaliteti i sintonizuesit) dhe shtypni 〈 / 〉 për të përzgjedhur **Cable** (Lidhje Kabllore), **Antenna** (Antenë) ose **Satellite** (Satelit). *(Shënim: Opsioni **Satellite** (Satelit) është i disponueshëm vetëm në modelet e zgjedhura.)*
5. Shtypni ∧ / ∨ për të përzgjedhur opsione të tjera për të konfiguruar.
6. Pasi të ketë mbaruar konfigurimi, shtyp ∨ për të zgjedhur **Search** (Kërkim) dhe shtyp **OK** për të filluar skanimin e kanaleve.
7. Kërkimi i kanalit mund të zgjasë disa minuta. Pas kërkimit automatik, kanalet rregullohen në një mënyrë të paracaktuar. Nëse dëshironi të ndryshoni listën e kanaleve, shtypni ✿ në telekomandë, zgjidhni **Settings > Channels and inputs > Channel > Edit Channels** (Cilësimet > Kanalet dhe hyrjet > Kanali > Ndrysho kanalet) dhe shtypni **OK** për të hyrë.

   *Shënim: Opsioni i **Edit Channels** (Ndrysho kanalet) nuk është i disponueshëm kur **Tuner mode** (Modaliteti i sintonizuesit) është i vendosur në **Antenna** (Antenë) dhe **Country/ Region** (Vendi/ Rajoni) është përgjedhur Mbretëria e Bashkuar.*

Ndërfaqe e përbashkët

Kanalet televizive dixhitale të koduara mund të deshifrohen me anë të një moduli të ndërfaqes së përbashkët dhe një karte të mundësuar nga një ofrues i shërbimeve televizive dixhitale.

Moduli i ndërfaqjes së përbashkët mund të aktivizojë disa shërbime dixhitale, në varësi të operatorit dhe shërbimeve që ju zgjidhni (për shembull, TV me pagesë). Kontaktoni operatorin e shërbimit tuaj dixhital të TV për më shumë informacion në lidhje me shërbimet dhe kushtet.

Përdorimi i modulit të ndërfaqes së përbashkët

PARALAJMËRIM: Fikeni TV tuaj para se të vendosni një modul të përbashkët të ndërfaqes. Sigurohuni që të ndiqni udhëzimet e përshkruara më poshtë. Vendosja e gabuar i një moduli të përbashkët të ndërfaqes mund të dëmtojë si modulin ashtu dhe TV tuaj.

1. Në përputhje me udhëzimet e shtypura në modulin e përbashkët të ndërfaqes, vendosni me delikatesë modulin në folenë e përbashkët të ndërfaqes në TV.
2. Shtyni modulin deri në fund.
3. Ndizni TV dhe prisni që të aktivizohet funksioni i përbashkët i ndërfaqes. Kjo mund të zgjasë disa minuta.

   Shënim: Mos e hiqni modulin e ndërfaqes së përbashkët nga foleja. Heqja e modulit do të ç'aktivizojë shërbimet dixhitale.

Përdorimi i shërbimeve të përbashkëta të ndërfaqes

Pas futjes dhe aktivizimit të modulit të ndërfaqes së përbashkët, shtypni ✿ në telekomandë, zgjidhni **Settings > Channels and inputs > Channel > Common interface** (Cilësimet > Kanalet dhe hyrjet > Kanal > Ndërfaqe e përbashkët) dhe shtypni **OK** për t'u futur.

Ky variant i menusë është i disponueshëm vetëm në qoftë se moduli i përbashkët i ndërfaqjes është vendosur dhe aktivizuar në mënyrë korrekte. Aplikacionet dhe përmbajtja në ekran janë mundësuar nga ofruesi i shërbimit tuaj dixhital të TV.

Përdorimi i titrave

Ju mund të aktivizoni titrat për çdo kanal televiziv. Titrat transmetohen përmes Teletekstit ose me anë të transmetimeve dixhitale DVB-T/DVB-C/DVB-S/ DVB-T2/DVB-S2. Me transmetimet dixhitale, ju keni mundësinë shtesë të zgjedhjes së një gjuhë të preferuar të titrave.

Aktivizimi/ç'aktivizimi i titrave

1. Shtypni ✿ në telekomandë, zgjidhni **Settings > Channels and inputs > Channel > Subtitle** (Cilësimet > Kanalet dhe hyrjet > Kanali > Titra) dhe shtypni **OK /** 〉 për të hyrë.

2. Zgjidhni opsionin **Subtitle** (Titra), dhe shtypni **OK** për të ndryshuar ndërmjet ON apo OFF (ndezur, fikur).
3. Shtypni ← për t'u kthyer në menunë e mëparshme.

Aktivizimi i gjuhëve të titrave në kanalet televizive dixhitale

1. Shtypni ✿ në telekomandë, zgjidhni **Settings > Channels and inputs > Channel > Subtitle > Digital subtitle language 1st** (Cilësimet > Kanalet dhe hyrjet > Kanali > Titra > Gjuha e parë dixhitale e titrave) dhe shtypni **OK /** › për t'u futur.
2. Shtypni ∧ / ∨ për të zgjedhur një gjuhë të titrave si gjuhën tuaj të preferuar dhe shtypni **OK** për ta konfirmuar.
3. Shtypni ∧ / ∨ për të zgjedhur **Digital subtitle language 2nd** (Gjuha e dytë dixhitale e titrave) dhe shtypni **OK /** › për të hyrë.
4. Shtypni ∧ / ∨ për të zgjedhur një gjuhë të dytë dixhitale të titrave dhe shtypni **OK** për ta konfirmuar.
5. Shtypni ← për t'u kthyer në menunë e mëparshme.

Përzgjedhja e një tipi titrash në kanalet televizive dixhitale

1. Shtypni ✿ në telekomandë, zgjidhni **Settings > Channels and inputs > Channel > Subtitle > Subtitle type** (Cilësimet > Kanalet dhe hyrjet > Kanali > Titra > Tipi i titrave) dhe shtypni **OK /** › për të hyrë.
2. Shtypni ∧ / ∨ për të zgjedhur një lloj titrimi dhe **OK** për ta konfirmuar. Ju mund të zgjidhni **Hearing Impaired** (Personat me vështirësi dëgjimi) për të shfaqur titrat për personat me vështirësi dëgjimi me gjuhën tuaj të zgjedhur.
3. Shtypni ← për t'u kthyer në menunë e mëparshme.

Përdorimi i Teletekstit

Përzgjedhje e deshifrimit të faqes së gjuhës

1. Shtypni ✿ në telekomandë, zgjidhni **Settings > Channels and inputs > Channel > Teletext > Decoding page language** (Cilësimet > Kanalet dhe hyrjet > Kanali > Teleteksti > Deshifroni gjuhën e faqes) dhe shtypni **OK /** › për të hyrë.
2. Shtypni ∧ / ∨ për të zgjedhur tipin e përshtatshëm të gjuhës që do të shfaqë Teleteksti dhe shtypni **OK** për ta konfirmuar.
3. Shtypni ← për t'u kthyer në menunë e mëparshme.

Gjuha Dixhitale e Teletekstit

Në kanalet televizive dixhitale, në varësi të transmetuesit, ju mund të jeni në gjendje të përfitoni një shërbim me faqe të shumta fillestare Teleteksti në gjuhë të ndryshme. Ky funksion iu mundëson të zgjidhni një gjuhë të disponueshme si gjuhë parësore, e cila lidhet me faqe të ndryshme fillestare të Teletekstit.

1. Shtypni ✿ në telekomandë, zgjidhni **Settings > Channels and inputs > Channel > Teletext > Digital teletext language** (Cilësimet > Kanalet dhe hyrjet > Kanali > Teletekst > Gjuha dixhitale e teletekstit) dhe shtypni **OK /** › për të hyrë.
2. Shtypni ∧ / ∨ për të zgjedhur një gjuhë dhe shtypni **OK** për ta konfirmuar.
3. Shtypni ← për t'u kthyer në menunë e mëparshme.

Kontrolli Elektronik i Konsumatorit (CEC)

Përdoreni këtë funksion për të kërkuar pajisje CEC të lidhura me prizat HDMI në TV tuaj dhe për të mundësuar shikimin me një prekje (one-touch play) dhe pauzën me një prekje (one-touch standby) mes pajisjeve CEC.

Aktivizimi apo ç'aktivizimi i CEC

1. Shtypni ✿ telekomandën, zgjidhni select **Settings > Channels and inputs > Inputs > External devices control (CEC)** (Cilësimet > Kanalet dhe hyrjet > Hyrjet > Kontrolli i pajisjeve të jashtme (CEC)) dhe shtypni **OK /** › për të hyrë.
2. Zgjidhni opsionin e **HDMI Control** (Kontrollit HDMI) dhe shtypni **OK** për të ndërruar ose fikur.
3. Shtypni ← për t'u kthyer në menunë e mëparshme.

Përdorimi i Ndezjes Automatike

Lejon ndezjen automatike të TV me aktivizimin e një pajisje CEC (p.sh. DVD) me anë të telekomandës së pajisjes. Shtypni **OK** për ndezur dhe aktivizuar këtë funksion.

Përdorimi i Pauzës Automatike

Lejon që të gjitha pajisjet e CEC-së të kalojnë automatikisht në gjendjen e pauzës me fikjen e TV me telekomandën e TV-së. Shtypni **OK** për ndezur dhe aktivizuar këtë funksion.

Shënim: Funksionet CEC kushtëzohen nga pajisjet e lidhura dhe është e mundur që disa pajisje të mos ndërveprojnë në mënyrë korrekte kur lidhen me këtë TV. Për informacion të mëtejshëm duhet të konsultohet manuali i përdoruesit ose prodhuesi i pajisjeve problematike.

HbbTV

HbbTV (TV me bandë të gjerë për transmetime hibride/ Hybrid broadcast broadband TV) është një shërbim i ofruar nga transmetues të caktuar dhe i disponueshëm vetëm në disa kanale televizive dixhitale. HbbTV transmeton televizion interaktiv mbi internet me bandë të gjerë. Këto karakteristika interaktive janë shtuar dhe kanë pasuruar programet

normale dixhitale, dhe përfshijnë shërbime të tilla si teletekst dixhital, udhëzues i programit elektronik, lojra, votim, informacion specifik në lidhje me programin aktual, reklama interaktive, revista informative, aplikacioni catch-up TV, etj.

Për të përdorur HbbTV ju lutem sigurohuni që TV juaj të jetë i lidhur në internet dhe HbbTV të jetë i ndezur.

Shënime:
- *Shërbimet HbbTV kushtëzohen nga transmetimi apo vendi dhe mund të mos jenë të disponueshme në zonën tuaj.*
- *Ju nuk mund të shkarkoni dosje në TV tuaj me funksionin HbbTV.*
- *Ofruesi i aplikacionit ose kushtet e lidhura me transmetimin mund të bëjnë që një aplikacion HbbTV të mos jetë i disponueshëm për momentin.*
- *Për të hyrë në aplikacionet HbbTV ju duhet të lidhni televizorin me internetin përmes një lidhje me bandë të gjerë. Aplikacionet HbbTV mund të mos funksionojnë si duhet në rastin e problemeve të lidhura me rrjetin.*

Hyrja në HbbTV

1. Shtypni ✿ në telekomandë, zgjidhni **Settings > System > HbbTV settings** (Cilësimet > Sistemi > Cilësimet e HbbTV) dhe shtypni **OK** / 〉 për t'u futur. Përzgjidhni opsionin **HbbTV** dhe shtypni **OK** për ta ndezur.
2. Kur ju sinkronizoheni me një kanal televiziv dixhital që ofron HbbTV, kjo do t'ju sinjalizohet nga një tregues që shfaqet në ekran (në përgjithësi një buton i kuq, por mund të përdoren gjithashtu edhe butona të tjerë me ngjyra). Shtypni butonin e dhënë të ngjyrës për të hapur faqet interaktive.
3. Përdorni ∧ / ∨ / 〈 / 〉 dhe butonat me ngjyra për të lundruar nëpër faqet HbbTV dhe shtypni **OK** për ta konfirmuar.

Ç'aktivizimi i HbbTV

Për të shmangur çrregullimet që mund të shkaktohen nga testet e transmetimit HbbTV, ju mund të ç'aktivizoni funksionin HbbTV:

1. Shtypni ✿ në telekomandë, zgjidhni **Settings > System > HbbTV settings** (Cilësimet > Sistemi > Cilësimet e HbbTV) dhe shtypni **OK** / 〉 për t'u futur.
2. Përzgjidhni opsionin **HbbTV** dhe shtypni **OK** për ta fikur dhe çaktivizuar.

Përdorim i EPG (Udhëzuesi i Programit Elektronik)

EPG është një udhëzues në ekran që tregon programet televizive dixhitale të programuara. Ju mund të lundroni, të zgjidhni dhe të shihni programet.

1. Shtypni ✿ telekomandën, zgjidhni **Settings > Channels and inputs > Channel > EPG** (Cilësimet > Kanalet dhe hyrjet > Kanali > EPG) dhe shtypni **OK** për të hyrë, ose shtypni 📺 telekomandën (nëse është e disponueshme), do të shfaqet menyja **Programme Guide** (Udhëzuesit të Programit), e cila ju lejon të merrni informacione në lidhje me programi aktual ose i radhës që luan në secilin kanal. Navigoni nëpër programe të ndryshme duke përdorur butonat ∧ / ∨ / 〈 / 〉 on në telekomandë.
2. Përdorni butonat përkatës që shfaqen në të majtë të ekranit për të parë EPG.
   - **Filter** (Filtri)**:** Filtri i udhëzuesit të programit për programet televizive dixhitale.
     - Navigoni nëpër llojet e ndryshme duke përdorur butonat ∧ / ∨ në telekomandë.
     - Zgjidhni një ose më shumë lloje, të cilat dëshironi të evidentoni nga lista e llojeve, shtypni **OK** për të përzgjedhur ose hequr përzgjedhjen. Një shenjë kontrolli do të shfaqet në të majtë të llojit përkatës kur të bëhet përzgjedhja.
   - **Schedule List** (Lista e Orarit)**:** Shtypni butonin **OK** për të hyrë, më pas zgjidhni **Schedule reminder** (Rikujtues i orarit) për të vendosur Kanalin, Data, Koha e rikujtesës dhe Përsëritja.
3. Shtypni ← për t'u kthyer në menunë e mëparshme.

Funksioni Bluetooth

(Nuk është e disponueshme për disa modele)*

Bluetooth® është një standard i teknologjisë wireless (me valë) për shkëmbimin e të dhënave në një distancë të shkurtër ndërmjet pajisjeve Bluetooth. Ju mund të lidhni pajisjen audio të Bluetooth, mausin apo tastierën përmes TV.

1. Shtypni ✿ telekomandën, zgjidhni **Settings > Remotes and accessories** (Cilësimet > Telekomandat dhe aksesorët) dhe shtypni **OK** / 〉 për të hyrë.
2. Zgjidhni **Pair accessory** (Çiftoni aksesorët) dhe shtypni **OK** për të hyrë. TV do të kërkojë automatikisht pajisjet e afërta Bluetooth. Zgjidhni një pajisje të disponueshme, shtypni **OK** dhe ndiqni udhëzuesit në ekran për ta lidhur atë.

Shënim: Teknologjia Bluetooth (nëse është e disponueshme në TV tuaj) përdor frekuenca 2.4GHz të cilat mund të shkaktojnë ndërhyrje të transmetimit audio nëpërmjet Bluetooth në afërsi të pikave hyrëse të Wi-Fi, Ruterave dhe furrave me mikrovalë. Nëse ju përballeni me ndërprerje të marrjes së zërit ju duhet të rindizni pajisjen tuaj Bluetooth për të gjetur një frekuencë me më pak ndërhyrje dhe nëse vazhdoni të keni probleme ju

duhet të afroheni më pranë TV tuaj ose të zmadhoni largësinë midis TV dhe burimit të ndërhyrjes.

Fjala dhe logot Bluetooth® janë marka tregtare të regjistruara në pronësi të Bluetooth SIG, Inc. dhe çdo përdorim i këtyre shenjave nga TTE Corporation është nën licencë. Markat e tjera tregtare dhe emrat tregtarë janë ato të pronarëve të tyre përkatës.

Funksioni i fillimit të shpejtë

Ai ju mundëson ta ndizni TV-në më shpejt nga regjimi në pritje sesa kur ky funksion është i çaktivizuar, por gjithashtu do të rrisë konsumin e energjisë gjatë regjimit në pritje.

1. Shtypni ⚙ në telekomandë, zgjidhni **Settings > System > Power and energy > Quick start** (Cilësimet > Sistemi > Fuqia dhe energjia > Fillimi i shpejtë) dhe shtypni **OK** / ❯ për të hyrë.
2. Zgjidhni opsionin e **Quick start** (Fillimi i shpejtë) dhe shtypni **OK** për të ndërruar dhe fikur.
3. Shtypni ← për t'u kthyer në menunë e mëparshme.

Rrjeti po zgjohet

Ky funksion ju lejon që të ndizni TV tuaj nga modaliteti i pauzës/pritjes përmes një rrjeti. Për përdorimin e këtij funksioni, ju lutem sigurohuni që:

1. TV-ja është lidhur me një rrjet shtëpie efikas me valë;
2. Komanduesi i dëshiruar, si p.sh. celulari është i lidhur me të njëjtin rrjet me valë, si dhe TV-ja;
3. Një aplikacion që mbështet funksionin e zgjimit nga rrjeti, si p.sh. Youtube është instaluar te komanduesi;
4. Në mënyrën Google TV, shtypni ⚙ telekomandën, zgjidhni **Settings > Network and Internet > Network standby** (Cilësimet > Rrjeti dhe interneti > Në gatishmëri në rrjet) dhe shtypni **OK** për ta ndezur.

Kur televizori ndodhet në modalitetin e standby (gadishmërisë) në rrjet, mund t'a përdorni aplikacionin për t'a zgjuar televizorin nga distanca.

Shënime:

- *Ky opsion çaktivizohet nëse shtypni dhe mbani të shtypur butonin ⏻ në telekomandë dhe konfirmoni fikjen e televizorit.*
- *Përpara se të përdorni opsionin e zgjimit në rrjet, sigurohuni që funksioni i **Quick start** (Fillimi i shpejtë) të jetë i aktivizuar.*
- *Ky funksion mund të mos jetë në dispozicion për modele të caktuara.*
- *Ky opsion është në dispozicion vetëm në modalitetin Google TV.*

Rikthimi në cilësimet e paracaktuara fabrikisht

Ju lejon të riktheni televizorin në cilësimet e paracaktuara fabrikisht.

1. Shypni ⚙ në telekomandë, zgjidhni **Settings > System > About > Reset > Factory reset** (Cilësimet > Sistemi > Rreth > Rikthim > Rikthim në gjendje fabrike) dhe shtypni **OK** për të konfirmuar.
2. Zgjidhni opsionin e **Factory reset** (Rikthim në gjendje fabrike) dhe shtypni **OK** për të hyrë. Pastaj zgjidhni **Delete Everything** (Fshi gjithçka) dhe shtypni **OK** për t'a konfirmuar.
3. Futni fjalëkalimin që keni vendosur ose kodin PIN sipas kërkesës së shkruar në ekran.
4. Zgjidhni **OK** dhe shtypni **OK** për t'a konfirmuar.
5. Në ekran shfaqet mesazhi i **Welcome** (Mirë se erdhët). Ndiqni udhëzimet në seksionin **Initial Setup** (Konfigurimi fillestar)

Përdorimi i kontrollit zanor pa duar të televizorit

Përpara se të përdorni opsionin e kontrollit zanor pa duar të televizorit, lidheni televizorin në rrjet dhe sigurohuni që ai fillimisht të ketë akses në faqen e internetit të Google. Pastaj ndiqni hapat e mëposhtëm për të hyrë në rrjet.

1. Aktivizoni çelësin e integruar të mikrofonit (Ju lutemi referojuni Udhëzuesit të Startimit të Shpejtë për të gjetur çelësin e mikrofonit në televizorin tuaj) përpara se t'a përdorni këtë funksion.
2. Në modalitetin Google TV, shtypni 🎤 në telekomandë.
3. Zgjidhni "Yes, I'm in (Po, kam hyrë)".
4. Thuaj "OK Google (Okej Gugël)" ose "Hey Google (Hej Gugël)" për t'a aktivizuar.

   Shënime:

   - *Ky opsion i kontrollit zanor pa duar të televizorit është i disponueshëm vetëm për modelet e përzgjedhura. Për detaje, ju lutemi drejtojuni dyqanit të zonës suaj.*
   - *Gjatë përdorimit, nevojitet një mjedis i qetë për një punim sa më të mirë. Distanca e rekomanduar për përdorimin e opsionit të kontrollit zanor pa duar të televizorit është deri 2 metra përballë tij.*
   - *Stakojeni çelësin e integruar të mikrofonit nëse nuk keni ndër mend t'a përdorni.*
   - *Disponueshmëria e opsionit të kontrollit zanor pa duar të televizorit varet nga rajoni/vendi/gjuha juaj.*
   - *Aktivizojeni si **Quick Start** (Fillimi i shpejtë) ashtu edhe **Screenless service** (Shërbimin pa ekran) në menunë **Settings > System > Power***

and energy *(Cilësimet > Sistemi > Rryma dhe energjia) për të shijuar opsionin e kontrollit zanor pa duar në modalitetin e standby (gadishmërisë) të televizorit.*

- *Konsumi i energjisë gjatë gjendjes së gatishmërisë do të rritet sepse mikrofoni i integruar është gjithmonë në punë kur aktivizohet Asistenti i Google ose opsioni i kontrollit zanor me mikrofon të integruar.*
- *Ky opsion është në dispozicion vetëm në modalitetin Google TV.*

Shpejtësia e Ndryshueshme e Rifreskimit

Shpejtësia e Ndryshueshme e Rifreskimit është një opson i cili mundëson luajtjen e rehatshme të lojërave dhe eliminon dridhjet e vrullshme të ekranit. Shpejtësia e rifreskimit mund të ndryshojë në mënyrë dinamike deri në 144 Hz. *(Shënim: Duhet të vendosni funksionin* ***Game Master*** *(Loja Master) në* ***Auto*** *(Automatik) ose* ***On*** *(Ndizni) për ta përdorur atë.)*

Nën burimin e HDMI1, HDMI2, HDMI3 ose HDMI4 (numri i folesë HDMI në televizor ndryshon në varësi të modelit të televizorit).

Shënime:

- *4K@144Hz është i disponueshëm vetëm për HDMI 1 (nuk është i disponueshëm në të gjitha modelet). Karta grafike e kompjuterit duhet të jetë në gjendje të ofrojë 144 Hz në dalje, ju lutemi kontrolloni specifikimet e kartës suaj grafike.*
- *4K@120Hz është i disponueshëm vetëm në HDMI 1 ose HDMI 2.*
- *disa modele suportojnë shpejtësi të rifreskimit deri në 120 Hz.*
- *Duhet të siguroheni që paneli juaj i komandimit të lojërave ose kompjuteri juaj të suportojë opsionin e Shpejtësia e Ndryshueshme e Rifreskimit dhe për këtë, mund t'ju duhet të kontrolloni cilësimet e panelit të komandimit të lojërave për t'a aktivizuar këtë funksion.*
- *Edhe loja/përmbajtja duhet gjithashtu të suportojë opsionin e Shpejtësia e Ndryshueshme e Rifreskimit dhe për këtë mund t'ju duhet të kontrolloni cilësimet brenda lojës.*

Apple AirPlay dhe HomeKit

** Nuk është e disponueshme për disa modele)*

Shkëmbeni materiale me televizorin tuaj përmes valëve duke përdorur AirPlay dhe kontrollojeni televizorin tuaj duke përdorur aplikacionin Home në iPhone, iPad ose Mac. Ju mund të konfiguroni në çdo kohë opsionin AirPlay dhe HomeKit nga menuja e Cilësimeve.

Funksioni është i aktivizuar në pënyrë të paracaktuar. Për të përdorur këtë funksion, sigurohuni që iPhone, iPad-i ose Mac-u juaj të jetë pajisje iOS ose iPadOS dhe që opsioni WiFi në pajisjen iOS ose iPadOS të jetë i aktivizuar. Pastaj ndiqni hapat e mëposhtëm për të vepruar.

1. Shtypni ✿ në telekomandë, zgjidhni **Settings > System > AirPlay and HomeKit Settings > Apple AirPlay and HomeKit** (Cilësimet > Sistemi > Cilësimet AirPlay dhe HomeKit > Apple AirPlay dhe HomeKit) dhe pastaj shtypni **OK** për të hyrë, ose shtypni ⮆(nëse është e disponueshme) në telekomandë, pastaj zgjidhni **AirPlay > AirPlay and HomeKit Settings** (AirPlay > Cilësimet AirPlay dhe HomeKit) dhe shtypni **OK** për të hyrë.
2. Shtypni ∧ / ∨ për të përzgjedhur gjërat e dëshiruara dhe shtypni **OK** për të hyrë në nënmenunë përkatëse.
3. Shtypni ← për t'u rikthyer në menunë e mëparshme.
4. Herën e parë, aktivizoni funksionin e pasqyrimit në ekran në iPhone, iPad ose Mac dhe përzgjidhni emrin e televizorit që dëshironi të lidhni në listën e kërkimit.
5. Nëse në ekranin e televizorit shfaqet një kod hyrjeje në AirPlay, futni kodin e hyrjes në pajisjen tuaj iOS ose iPadOS.
6. Për të ndaluar pasqyrimin në ekran të pajisjes suaj iOS ose iPadOS, hapni Qendrën e Kontrollit, shtypni pasqyrimin në ekran dhe më pas shtypni opsionin stop pasqyrimit.

   Shënime:

   - *Nëse WiFi i juaj është i fikur, shtypni ✿ në telekomandë, zgjidhni* ***Settings > Network and Internet > Wi-Fi*** *(Cilësimet > Rrjeti dhe Interneti > Wi-Fi), dhe pastaj shtypni* ***OK*** *për t'a ndezur.*
   - *Për të çaktivizuar këtë opsion, zgjidhni* ***Settings > System > AirPlay and HomeKit Settings > Apple AirPlay and HomeKit > AirPlay*** *(Cilësimet > Sistemi > Cilësimet AirPlay dhe HomeKit > Apple AirPlay dhe HomeKit> AirPlay) dhe pastaj shtypni* ***OK*** *për t'a fikur.*
   - *Apple, AirPlay dhe HomeKit janë marka tregtare të Apple Inc., të regjistruara në Sh.B.A dhe vendet e tjera.*
   - *Ky Smart TV Pro është kompaktibël me AirPlay 2 dhe HomeKit. Nevojitet një sistem operativ iOS 12.3 ose më i ri ose macOS 10.14.5 ose më i ri.*

Multi Vizuale

Ju lejon të shijoni programe të ndryshme me familjen tuaj në një televizor të vetëm në të njëjtën kohë.

Funksioni multi vizuale është i aktivizuar në mënyrë të parapërzgjedhur. Për të përdorur këtë funksion, sigurohuni që telefoni juaj të jetë me sistem operativ Android dhe WiFi në telefon të jetë i aktivizuar. Pastaj ndiqni hapat e mëposhtëm për të vepruar.

1. Shtypni ✿ në telekomandë, zgjidhni **Settings >Network and Internet > Wi-Fi** (Cilësimet > Rrjeti dhe Interneti > Wi-Fi), dhe pastaj shtypni **OK** për t'a aktivizuar.
2. Shtypni ⮆ në telekomandë, pastaj shtypni **Multi Visual** (Multi Vizuale), Përzgjidhni modalitetin tuaj të dëshiruar të ekranit dhe pastaj shtypni **OK** për të hyrë. Shtypni "**Start now** (Fillo tani)" për t'u lidhur.
3. Aktivizoni funksionin e transmetimit në ekran në telefonin tuaj dhe përzgjidhni emrin e televizorit që dëshironi të lidhni në listën tuaj të kërkimit.
4. Herën e parë, në varësi të llojeve të ndryshme të telefonave, mund të ndesheni me dy situata të ndryshme:
   - Mund të shfaqet një mesazh ftese, zgjidhni **Accept** (Prano) dhe shtypni **OK** për t'u lidhur.
   - Futni një kod PIN të saktë për t'u lidhur sipas mesazhit PIN të ardhur në telefon.
5. Për të dalë nga funksioni multi vizuale, shtypni ←, pastaj zgjidhni **OK** dhe shtypni **OK** për t'a konfirmuar.

   Shënime:
   - *Ky opsion nuk është i disponueshëm në rastet e mëposhtme:*
     - *kur televizori është duke përdorur Netflix ose Media Player.*
     - *nëse videoja nga telefoni/DTV është e koduar.*
     - *kur kapaciteti i dekodimit të kërkuar të videos i kalon 4K 60Hz.*
   - *Kur televizori është në modalitetin e ekranit të plotë, mund të ndodhë dështimi për t'u rikthyer në pamjen e dyfishtë për shkak të problemeve të përputhshmërisë së aplikacioneve të palëve të treta.*
   - *Mund të përdoren disa telefona njëherësh. Kur ndodheni në modalitetin e pamjes së dyfishtë, përdorni 〈 / 〉 për të zhvendosur fokusin në pamjen e televizorit dhe për të transmetuar më pas pamjet e një telefoni tjetër në televizor.*
   - *Për të kontrolluar të gjithë listën e disponueshme të historisë, shtypni ✿ në telekomandë, zgjidhni **Settings > System > Multi visual settings > Connection list** (Cilësimet > Sistemi > Cilësimet Multi Vizuale > Lista e lidhjeve) dhe pastaj shtypni **OK** për të hyrë.*

Filtri i Dritës Blu

Redukton sasinë e dritës blu të emetuar nga ekrani, gjë që mund të zvogëlojë lodhjen vizuale të lidhur me të shikuarit e ekranit.

1. Shtypni ✿ në telekomandë për të shfaqur pultin, zgjidhni **Picture > Advanced Settings > Colour** (Pamja > Cilësimet e avancuara > Ngjyra) dhe shtypni **OK** 〉 për të hyrë.
2. Zgjidhni opsionin **Blue Light Filter** (Filtri i Dritës Blu) dhe shtypni **OK** për t'a aktivizuar ose çaktivizuar.

   Shënime:
   - *Pasi të keni parë në televizor për gjysmë ore, ju lutemi largohuni nga televizori dhe bëjini sytë të pushojnë.*
   - *Kur pushoni, ju lutemi hidhini sytë larg për të rregulluar muskujt ciliarë të syrit për të shmangur kështu tensionin e syve.*
   - *Ju lutemi, krijoni një rutinë të dobishme për sa i përket të ushtruarit e sytë për të mbrojtur kështu shikimin dhe për të parandaluar miopinë.*

Fjalëkalimi në Kontrollin Prindëror

- Vendosni fjalëkalimin në menunë **Settings > System > Lock** (Cilësimet > Sistemi > Kyçje).
- Super fjalëkalimi është 0423. Nëse ju harroni kodin tuaj, futni super fjalëkalimin për të kapërcyer secilin nga kodet ekzistuese.

Zgjidhja e problemeve

Ju lutem kontrolloni listën e mëposhtme përpara se të kërkoni shërbimin.

Nuk ka figurë ose zë.

- Sigurohuni që kordoni i rrymës të jetë futur siç duhet në prizën e furnizimit me energji.
- Sigurohuni tipi i burimit të jetë vendosur në mënyrën e duhur.
- Sigurohuni që antena të jetë lidhur siç duhet.
- Sigurohuni që volumi nuk është vendosur në minimum ose zëri nuk është vendosur në modalitetin pa zë (mute).
- Sigurohuni që kufjet të mos jenë të lidhura.
- TV mund të jetë duke marrë një sinjal që nuk ka lidhje me stacionet transmetuese televizive.

Figura nuk është e qartë.

- Sigurohuni që kablli i antenës të jetë lidhur siç duhet.
- Merrni në konsideratë nëse sinjali i TV tuaj po merret siç duhet.
- Cilësia e dobët e figurës mund të ndodhë për shkak të një aparati fotografik VHS, videokamerës, apo elementi tjetër periferik të lidhur në të njëjtën kohë. Shkëputni një nga pjesët e tjera periferike.
- Ghost/fantazma apo figura e dyfishtë mund të shkaktohet nga pengimi i antenës për shkak të kodrave apo ndërtesave të larta. Përdorimi i një antene më drejtim nga lart mund të përmirësojë cilësinë e figurës.
- Vijat horizontale me pika që shfaqen tek figurat mund të shkaktohen nga ndikimet e mundshme elektrike, psh, tharëse flokësh, drita të afërta neoni, etj. I shuani ose i largoni ato.

Figura është shumë e errët, shume e hapur apo e ngjyrosur.

- Kontrolloni rregullimin e ngjyrave.
- Kontrolloni konfigurimin e ndriçimit.
- Kontrolloni funksionin e mprehtësisë.

Telekomanda nuk funksionon.

- Kontrolloni bateritë në telekomandë.
- Sigurohuni dritarja e sensorit në distancë në pjesën e përparme të TV të mos jetë nën ndriçim të fortë fluoreshent.
- Mundohuni të pastroni dritaren e sensorit në distancë në pjesën e përparme të TV me një leckë të butë.

Në qoftë se sugjerimet e mësipërme nuk e zgjidhin problemin tuaj teknik, ju lutem referojuni kartës së garancisë për informacion në lidhje me shërbimin.

Kushtet e funksionimit

Temperatura 5°C – 35°C (41°F – 95°F)
Lagështia 20 – 75% (jo kondensuese)

Kushtet e Ruajtjes

Temperatura -15°C – 45°C (5°F – 113°F)
Lagështia 10 – 90% (jo kondensuese)

Informacion per Radiotransmetimin

- Gama e frekuencës transmetuese Bluetooth®: 2402 – 2480 MHz
- Fuqia transmetuese Bluetooth®: 6dBm (+/-4 dB)
- Gama e frekuencës transmetuese Wi-Fi 2.4G: 2412 – 2472 MHz
- Fuqia transmetuese Wi-Fi 2.4G: 14 dBm (+4 dB/-5 dB)
- Gama e frekuencës transmetuese Wi-Fi 5G:
  - Brezi 1 i frekuencave: 5150 – 5250 MHz
  - Brezi 2 i frekuencave: 5250 – 5350 MHz
  - Brezi 3 i frekuencave: 5470 – 5725 MHz
  - Brezi 4 i frekuencave: 5725 – 5850 MHz
- Fuqia e transmetuesit 5G Wi-Fi: 14 dBm (+4 dB/-5 dB)
- Gama e frekuencës së sintonizuesit DVB-T/T2/C: 50,5 – 858 MHz
- Gama e frekuencës së sintonizuesit DVB-S/S2: 950 – 2150 MHz

* 5150–5350MHz është i kufizuar vetëm për përdorim të brendshëm.

	BE	BG	CZ	DK	DE	EE	IE
	EL	ES	FR	HR	IT	CY	LV
	LT	LU	HU	MT	NL	AT	PL
	PT	RO	SI	SK	FI	SE	UK (NI)

Njoftim OSS

Ky produkt përdor GPL (Versioni 2 dhe 3) LGPL (versioni 2.1) dhe MPL (versioni 1.1).

Për të dërguar aplikime dhe kërkesa për pyetje në lidhje me burimin e hapur, kontaktoni zytën më të afërt TCL.

Ky produkt përdor disa programe softueri të cilat janë shpërndarë në kuadër të Grupit të Pavarur JPEG.

Ky produkt përdor disa programe softueri të cilat janë shpërndarë në kuadër të Projektit libpng.

Ky produkt përdor disa programe softueri të cilat janë shpërndarë në kuadër të Projektit Freetype.

Ky produkt përdor disa programe softueri të cilat janë shpërndarë në kuadër të Projektit zlib.

Ky produkt përdor disa programe softueri (libxml2, curl, expat, c-areas) të cilat janë shpërndarë në kuadër të MIT.

Ky produkt përdor CyberLink për C i cili është shpërndarë nën Projektin Open Source.

Ky produkt përdor opensl, xerces i cili është shpërndarë nën Projektin Apache License.

Softueri GPL: Linux Kernel, glib, libiconv, gcc libgcc, gcc libstdc++, u-Boot loader, ffmepg, util-linux-ng, e2fsprogs, wget, iptables

Softueri LGPL: DFB (DirectFB), gstreamer, gst-plugins-base, gst-plugins-good, gst-plugins-bad, gst-plugins-ugly, gst-ffmpeg, glibc, wpa_supplicant

Softueri BSD: webp, mng, uriparser

Softueri GNU: dosfstools

[Deklarata ligjore] e TCL - Prodhuesi i kësaj pajisje televizive

Për shkak të aftësive të ndryshme të produkteve që ofrojnë TV Intelegjentë (SmartTV) - Shërbimet si dhe kufizimet në përmbajtjen e disponueshme, karakteristikat, aplikacionet, si dhe shërbime të caktuara mund të mos jenë të disponueshme në të gjitha pajisjet ose në të gjitha territoret. Disa karakteristika tek TV Intelegjentë (SmartTV) mund të kërkojnë pajisje shtesë periferike ose pagesa anëtarësimi të cilat shiten më vete. Ju lutem vizitoni faqen tonë të internetit për më shumë informacion mbi të dhënat specifike të pajisjes dhe disponueshmërinë e përmbajtjes. Shërbimet dhe disponueshmëria e përmbajtjes përmes TV Intelegjentë (SmartTV) janë subjekt i ndryshimeve të herëpashershme pa njoftim paraprak.

Të gjitha përmbajtjet dhe shërbimet e arritshme me anë të kësaj pajisje iu përkasin palëve të treta dhe mbrohen nga e drejta e autorit, patenta, marka tregtare dhe/ose ligje të tjera të pronësisë intelektuale. Përmbajtja dhe shërbime të tilla janë ofruar vetëm për përdorimin tuaj personal jo tregtar. Ju nuk mund të përdorni asnjë material ose shërbim në një mënyrë që nuk është autorizuar nga ana e pronari ose ofruesi i përmbajtjes. Pa kufizuar sa më sipër, përveç nëse autorizohet shprehimisht nga pronari i përmbajtjes së aplikueshme ose ofruesi i shërbimit, ju nuk mund të modifikoni, kopjoni, ripublikoni, ngarkoni, postoni, transmetoni, përktheni, të shitni, të krijoni vepra të rrjedhura, të shfrytëzoni, ose shpërndani në çfarëdo mënyre ose mjedisi ndonjë përmbajtje apo shërbim të shfaqur me këtë pajisje.

JU SHPREHIMISHT JENI INFORMUAR DHE BINI DAKORT QË PËRDORIMI I PAJISJES ËSHTË NË RISKUN TUAJ TË VETËM DHE SE I GJITHË RREZIKU LIDHUR ME CILËSINË E KËNAQSHME, PERFORMANCËN DHE SAKTËSINË BIE MBI JU. PAJISJA DHE GJITHË PËRMBAJTJA DHE SHËRBIMET E PALËVE TË TRETA OFROHEN "SI JANË" PA ASNJË LLOJ GARANCIE, TË SHPREHUR APO E NËNKUPTUAR. TCL SHPREHIMISHT HEDH POSHTË TË GJITHA GARANCITË DHE KUSHTET LIDHUR ME PAJISJEN DHE ÇDO PËRMBAJTJE DHE SHËRBIMEVE, QOFSHIN TË SHPREHURA APO, TË NËNKUPTUARA, DUKE PËRFSHIRË POR PA U KUFIZUAR ME, GARANCITË E SHITJES, TË CILËSISË TË KËNAQSHME, PËRDORIMIT PËR NJË QËLLIM TË CAKTUAR, TË SAKTËSISË, TË KËNAQËSISË TË QETË , DHE MOS-SHKELJES TË TË DREJTAVE TË PALËVE TË TRETA. TCL NUK GARANTON SAKTËSINË, VLEFSHMËRINË, AFATSHMËRINË, LIGJSHMËRINË, APO TËRËSINË E NDONJË PËRMBAJTJE DHE SHËRBIMI QË VIHET NË DISPOZICION NËPËRMJET KËSAJ PAJISJE DHE NUK GARANTON QË PAJISJA, PËRMBAJTJA OSE SHËRBIMET TË PLOTËSOJNË KËRKESAT TUAJA, OSE QË FUNKSIONIMI I PAJISJES OSE SHËRBIMET TË JENË TË PANDËRPRERA OSE PA GABIME. NË ASNJË RAST, DUKE PËRFSHIRË KËTU EDHE NEGLIZHENCËN, TCL NUK DO TË KONSIDEROHET PËRGJEGJËSE, QOFTË NË KONTRATË OSE NE FAJ, PËR NDONJË DËM DIREKT, INDIREKT, TË RASTËSISHËM, TË VEÇANTË OSE TË DERIVUESHËM, TARIFAT E AVOKATIT, SHPENZIMET, OSE ÇDO DËMTIM TJETËR QË VJEN NGA, APO NË LIDHJE ME, NDONJE INFORMACION QË GJENDET NË TË, OSE SI REZULTAT I PËRDORIMIT TË PAJISJES, OSE ÇDO LLOJ MATERIALI APO SHËRBIMI I PËRDORUR NGA JU APO NGA ÇDO PALE E TRETE, EDHE NËSE KËSHILLOHET PËR MUNDËSINË E DËMEVE TË TILLA.

Shërbimet e palëve të treta mund të ndryshohen, pezullohen, hiqen, ndërpriten ose ndalohen, apo hyrja në to mund të kufizohet në çdo kohë, pa njoftim, dhe TCL nuk ofron asnjë garanci ose përfaqësim se çdo përmbajtje ose shërbim do të mbetet i disponueshëm për çdo periudhë kohore. Përmbajtja dhe shërbimet janë transmetuar nga palët e treta me anë të rrjeteve dhe pajisjeve të transmetimit mbi të cilat TCL nuk ka kontroll. Pa kufizuar përgjithësinë e këtij refuzimi, TCL shprehimisht hedh poshtë çdo përgjegjësi ose detyrim për ndonjë ndryshim, ndërprerje, kufizim, heqje apo pezullim të çdo përmbajtje apo shërbimi në dispozicion me këtë pajisje. TCL mund të vendosë kufizime për përdorimin apo hyrjen në disa shërbime apo përmbajtje, në çdo rast dhe pa paralajmërim ose detyrim. TCL nuk është përgjegjëse apo e detyruar për shërbimin e klientit në lidhje me përmbajtjen dhe shërbimet. Çdo pyetje apo kërkesë për shërbim që lidhet me përmbajtjen ose shërbimet duhet të bëhet direkt tek ofruesit e përmbajtjes dhe të shërbimeve përkatëse.